

DHOMA E POSAÇME E  
GJYKATËS SUPREME TË  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË  
LIDHEN ME AGJENCINË  
KOSOVARE TË  
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE  
SUPREME COURT OF KOSOVO  
ON KOSOVO TRUST AGENCY  
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODNOSE NA  
KOSOVSKU  
POVERENIČKU AGENCIJU

**ASC-09-0038**

Në padinë e

[REDACTED]  
Fshati Slivovë, Ferizaj  
Përfaqësuar nga avokati [REDACTED]

*Paditësi*

kundër

[REDACTED]  
Ferizaj  
Përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Ilir Konushevci 8, Prishtinë

*I Padituri/Ankuesi*

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetari i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 4 shkurt 2010, lëshon këtë

## **A K T V E N D I M**

- 1. Pika 5 e aktvendimit të Trupit Gjykues të datës 19 janar )SCC-05-0518) ndryshohet dhe shuma e taksës gjyqësore zvogëlohet nga 1000 euro në **857,58.****
  
- 2. Përveç kësaj, ankesa kundër aktvendimit të Trupit Gjykues refuzohet si e pabazë.**

## **Gjendja Faktike dhe Procedurale:**

Më 11 nëntor 2005, Paditësi parashtrroi një padi kundër ████ në Ferizaj, duke kërkuar njohjen e të drejtës së pronësisë të ngastrave kadastrale përkatëse. Më vonë gjatë procedurës ai ka kërkuar kompensim alternativ me para për humbjet e tij.

Me Aktgjykimin e datës 19 janar 2009, SCC-05-0518, Trupi Gjyques miratoi padinë e Paditësit për njohjen e të drejtës së pronësisë të atyre ngastrave si të bazuar, por vetëm ngastrën 477/3 prej 11 akrave që janë jashtë rrethojës së ████, e cila ishte deklaruar të jetë pronë e Paditësit dhe ngastrat e tjera dhe një pjesë e ngastrës 477/3 ishte transferuar në emër të të Paditurit dhe ishte kompensuar Paditësi në shumën prej 152.895 euro. Në pikën 5 të dispozitivit të Aktgjykimit, Trupi Gjyques e obligoi të Paditurin ti paguajë tarifat e avokatit të Paditësit në shumën prej 280,80 euro, shpenzimet gjyqësore në shumën prej 1000 euro dhe tarifën e ekspertizës në shumën prej 210 euro.

Aktgjykimi ishte dorëzuar tek i Padituri më 10 shkurt 2009.

Më 24 shkurt 2009, i Padituri parashtrroi një ankesë kundër pikës 5 të këtij Aktgjykimi, lidhur me shpenzimet gjyqësore. I Padituri/Ankuesi kërkon që ankesa e tij të miratohet dhe ta shkarkojë atë nga obligimi i pagesës së taksës gjyqësore në shumën prej 1000 euro, si dhe pjesën tjetër të shpenzimeve gjyqësore.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës.

## **Arsyetimi Ligjor:**

Ankesa pjesërish aprovohet si e bazuar.

Para se trajtohet përmbajtja e ankesës, vërejtja jonë fillestare duhet të bëhet në lidhje me përfaqësimin e Ankuesit:

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) është themeluar në Nëntor 2002 me anë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13, të ndryshuar me Rreguloren 2005/18, ka pushuar së vepruari në qershor 2008. Veprimtaritë e saj, përfshirë edhe përfaqësimin e Ndërmarrjeve Shoqërore (SHT-të) pranë Dhomës së Posaçme në atë kohë janë bartur në përgjegjësinë e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Duke marrë në konsideratë gjendjen faktike në vend në Kosovë në lidhje me AKM-në që nuk ushtron më detyrat dhe përgjegjësitë e veta të përcaktuara me anë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13, të ndryshuar, dhe më tutje duke marrë në konsideratë që ekziston një nevojë e menjëhershme që NSH-të të përfaqësohen në mënyrën e duhur pranë Dhomës së Posaçme, si dhe duke marrë në konsideratë për parim bazë sistemet ligjore që ndjekin sundimin e ligjit nuk lejojnë vakuumet ligjore, atëherë përfaqësimi i NSH-ve nga AKP-ja tani për tani do të jetë i pranueshëm.

Prandaj, Ankuesi konsiderohet se është i përfaqësuar nga AKP-ja.

Ankuesi pohon se i Padituri nuk ishte pala e vetme e pasuksesshme në procedurë; Paditësi ka qenë i pasuksesshme gjithashtu, pasi që e mori të drejtën pronësore vetëm për disa pjesë të ngastrës 477/3. DHPGJS-ja ka zbatuar gabimisht Nenin 56.2 të Urdhëresës Administrative (UA) të UNMIK-ut 2008/6 në dëm të të Paditurit.

Në lidhje me këtë duhet të jepet kjo përgjigje:

Neni 56.2 i UA të UNMIK-ut 2008/6 thekson se pala e pasuksesshme urdhërohet që t'i paguajë shpenzimet ashtu siç është përcaktuar në aktgjykimin e formës së prerë. Sipas Nenit 56.3 të UA të përmendur kur secila palë ka sukses në disa kërkesa dhe dështon në të tjerat ose në raste të

jashtëzakonshme, Dhoma e Posacme mund të urdhërojë që shpenzimet të ndahen ose që palët t'i bartin vetë shpenzimet e veta.

Padia e Paditësit për njohjen e të drejtës së pronësisë për të gjitha ngastrat e përmendura në padi ishte pranuar si e bazuar. Paditësi ka qenë e vetmja palë e suksesshme në këtë çështje bazë të padisë. Fakti që Paditësi dhe i Padituri gjatë procedurës gjyqësore janë pajtuar se cilat ngastra do të transferohen tek i Padituri dhe se i Padituri do t'ia kompensojë Paditësit vlerën e atyre ngastrave nuk e vërteton atë lloj rasti të jashtëzakonshëm të cilat theksohen në Nenin 56.3 të UA-së së lartpërmendor. Paditësi gjithashtu në tërësi ka qenë pala e suksesshme në lëndë. Për atë arsyе i Padituri/Ankuesi obligohet të kompensojë tarifat e avokatit të Paditësit, shpenzimet gjyqësore dhe tarifën e ekspertizës.

Në ankesën e vet, Ankuesi ka pohuar se taksat gjyqësore janë llogaritur gabimisht. Sipas ankesës shuma e duhur e taksave gjyqësore në këtë lëndë është 295,79 euro.

Sipas tabelës në fuqi të shumës së tarifës gjyqësore për padi në DHPGJS, shuma e taksës gjyqësore llogaritet nga vlera e padisë. Shuma e përgjithshme e taksës gjyqësore është dy herë shuma e cila është llogaritur sipas asaj tabele. Në lëndën në fjalë, vlera e padisë është 169.395 euro. Nga shumat prej 5000 euro, taksa gjyqësore për padi është 100 euro duke shtuar 0.2 për qind të shumës që tejkalon 5000 euro. Prandaj shuma e duhur e taksës gjyqësore është 857,58 euro. Rrjedhimisht shuma e taksës gjyqësore zvogëlohet nga 1000 euro në 857,58 euro.

Për këto arsyë vendoset si në dispozitivin e këtij aktvendimi. Shpenzimet gjyqësore nuk kërkohen në procedurën ankimore.

Richard Winkelhofer, Gjyqtari Kryesues i EULEX-it nënshtkruar

Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it nënshtkruar

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it nënshtkruar

Tobias Lapke, Regjistrues i EULEX-it nënshtkruar